

VENDIM
Nr.106, datë 28.2.2007

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.638, DATË 18.9.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELIT TË PAGAVE TË
PUNONJËSVE TË INFERMIERISTIKËS, NË SISTEMIN E MINISTRISË SË
SHËNDETËSISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në lidhjen 1, që i bashkëlidhet vendimit nr.638, datë 18.9.2003 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

a) Në nënndarjen 19, te kreu 1.1 shtohet emërtesa “Kryeinfermier reparti në infektiv”.

b) Kreu 1.2 i lidhjes 1 zëvendësohet me kreun me të njëjtin numër, emërtim dhe përmbajtje, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2007, i miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja 1 (kreu 1.2)

STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E INFERMIERISTIKËS NË DREJTORITË
E SHËNDETIT PUBLIK NË RRETHE

NR.	EMËRTIMI	PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHITESA E POZICIONIT		
		Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Shef i sektorit të kujdesjeve infermiore		2%	0	15500		Nga...deri lekë
2	Specialist i sektorit të kujdesjeve infermiore		2%	0	14000		Nga...deri lekë
3	Infermier statistike		2%	0	12150		